

Kompania Rajonale e Mbeturinave  
 Regionalna Kompanija za Uklarstva i Otpada  
**PASTRIMI** sh.a  
 Nr br. 146 dt. 23.02.2020  
 Prishtine - Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE E SHprehur NE: 16.02.2020			
Nr. Pror. Nr. Pror. No.	Nr. Pror. Nr. Pror. No.	Nr. Pror. Nr. Pror. No.	Nr. Pror. Nr. Pror. No.
05	47	1578	34

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Musa Bislimi, Kryesues i Bordit dhe Burim Kelmendi, Kryeshf Ekzekutiv - Kompania Rajonale e Mbeturinave  
 Pastrimi.Sh.a



**OPINIONI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**  
 të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra  
 Kombëtare e Auditimit 2019

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Opinioni i Kundert	Arkëtimet në shumën prej 423,962€, nuk u janë zbritur konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara ndaj kompanisë, mirëpo këto	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që janë marrë veprimet e menjëhershme për të identifikuar	-Do të behet Identifikimi		01 Shtator 2020	

		<p>mjete ishin regjistruar në një ilogari me përshkrimin "Klient i panjohur institucione, komuna dhe amvisëri". Këto mjete në pasqyrën e pozitës financiare ishin prezantuar tek të hyrat e shtyra</p>	<p>konsumatorët, mjetet monetare të të cilëve janë grumbulluar në ilogarinë "Klient i panjohur" dhe se u janë zbritur obligimet e papaguara ndaj ndërmarrjes.</p>	<p>pagesave dhe kerkesave për shlyren e borxheve r</p> <p>-Do te kontaktohet me Banka dhe Institucionet te cilat i kane bere pagesat</p> <p>-Do te behet regjistrimi i te gjitha pagesave, te cilat kane adrese</p>	<p>Kontabiliteti dhe Financat</p>	<p>Shtator 2020</p> <p>Netor 2020</p>	
--	--	--	---	---	-----------------------------------	---------------------------------------	--

				per regjistrim			
2	Opinoni i Kundert	Është kërkesë e SNK 16 – Aktivët afatgjatë materiale, pika 40, që nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi ulet si rezultat i një rivlerësimi, ulja njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, ulja debitchet drejtpërdrejtë tek kapitalët e veta me titullin mbiviera (tepricë) rivlerësimi për aq sa ajo mbulon çdo tepricë kreditore tek mbiviera (teprica) rivlerësimi në lidhje me atë aktiv (nëse ekziston).	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që janë marrë veprimet korrigjuese në lidhje me regjistrimin e rënies së vlerës së tokës, në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë pamje të drejte dhe të vërtetë.	Do të korigjohet raporti Financiare PA per vitin 2019 ne 2020	Kontabiliteti dhe Financat	Dhjetor 2020	
3	Opinoni i Kundert	Sipas SNK 16 – Aktivët afatgjatë materiale, pas njohjes si një aktiv, një zë i aktiveve afatgjatë materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) vlera e drejtë e të cilëve matet me besueshmëri do të mbartet me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e bërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të bëhen korrigjimet e gabimeve të cilat kanë ndodhur me rastin e trajtimit të asetve pas rivlerësimit të tyre, në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë pamje të drejte dhe të vërtetë.	Do të korigjohet raporti Financiare PA per vitin 2019 ne 2020	Kontabiliteti dhe Financat	Dhjetor 2020	
4	Opinoni i Kundert	Neni 7 i Ligjit për Kontabilitet, Raportim	Krvesuesi i Bordit të sigurojë,	Do të Formohet	Kontabiliteti dhe Financat	Shtatore 2020	

		<p>Financiar dhe Auditim (nr. 04/L-014), Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi i pasurive dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues i shoqërive tregtare dhe duhet të barazohet me librat kontabël.</p>	<p>proceduara përkatëse të cilat do të shërbejnë si udhëzime të qarta për komisionet e inventarizimit lidhur me mënyrat e duhura të inventarizimit. Ndërsa brenda një afati të shkurtër kohor, të sigurohen regjistrat në mënyrë analitike të asetve të cilat i kanë në përdorim, në mënyrë që të mundësohet më pas, krahasimi dhe barazimi me të dhënat e komisioneve të inventarizimit.</p>	<p>komisioni për vendosjen e Barkodeve për pasuritë të cilat janë në zyrat administrative</p>			
5	Opinoni i Kundert	<p>Sipas SNK 16 – Aktivet afatgjata materiale, nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja kreditohet drejtpërdrejt tek kapitalat e veta me titullin mbivlerë (tepricë) rivlerësimi. Megjithatë, rritja njihet në fitim ose humbje për aq sa kjo mbulon uljen e</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që po bëhet një rishikim i datajuar i regjistrit të pasurive, dhe se janë marrë veprime korigjuese lidhur me rritjen/rënien e vlerës së asetve pas rivlerësimit të tyre, në mënyrë që</p>	<p>Do të korigjohet raporti Financiare PA për vitin 2019 në 2020</p>	<p>Kontabiliteti dhe Financat</p>	<p>Dnjetor 2020</p>	

		rivlerësimi e të njëjt t aktiv të njohur më parë në fitim ose humbje.	shuma rezervës së rivlerësimi të prezantohet saktë në pasqyrat financiare.				
6	Opinoni i Kundert	Sipas Kornizës Konceptuale (paragrafi 4.46) një detyrim njihet ne pasqyren e pozicionit financiar kur ka gjasa që burime ekonomike do të dalin nga njësia ekonomike për të shlyer një detyrim aktual dhe shuma me të cilën do të shlyhet detyrimi mund të matet me besueshmëri.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese të gabimeve në lidhje me detyrimet në të dhënat kontabël, në mënyrë që të bëhet një prezantim i saktë në pasqyrat financiare. Përveç kësaj, të krijohen mekanizma që regjistri i obligimeve të rishikohet në baza të rregullta kohore në mënyrë që të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve ndaj furnitorëve.	Do të behet harmonizimi i LLP sipas Furnitoreve , gjendjes se tyre dhe gjendjes aktuale ne komapani!	Kontabiliteti dhe Financat	Shtatore/2020	
7	Opinoni i Kundert	Sipas SNK 20 – Grantet: devertitare, grantet e marra për aktive të amortizueshme njihen si të archura gjatë	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të merren veprime korrigjuese në	Do të korigjohen te hyrat nga	Kontabiliteti dhe Financat	Nentor 2020	

	<p>periudhave në të cilat ngerkohet amortizimi për ato mjete. Në pasqyrën e të ardhurave të hyrat nga grandet ishin prezentuar në shumën 316,002€, shumë kjo e mbivlerësuar për 236,916€. Sipas konfirmimeve zyrtare, ky mbivlerësim kishte rrjedhë si pasojë e zbatimit të dy metodave të ndryshme të zhvlerësimit për të njëjtat grante. Për grandet e përfituara më herët se viti 2013, për qëllime të zhvlerësimit të pasurisë është zbatuar metoda drejtvizore e zhvlerësimit, ndërsa në regjistrat kontabël të granteve me qëllim të zvogëlimit të të hyrave të shtyra është zbatuar metoda e saldës zbritëse. Në vitin 2019 është bërë korrigjimi dhe njohja e këtyre të hyrave, për arsye se këto të hyra janë shpenzuar në vitet e mëhershme. Për veç kësaj, Kompania nga 18 asetet e financuara nga grandet posedon çështje vetëm për një aset. Për më tepër, të hyrat e shtyra nga Grandet,</p>	<p>periudhat paraardhëse në mënyrë që shumën e prezentuar në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e pozitës financiare, për të hyrat nga grandet dhe të hyrat e shtyra nga grantet të jetë e saktë.</p>	<p>grandet dhe do të koerkojen nga institucionet për dhenjen e granteve të paiseme me dokumenta shtesë!</p>			
--	--	---	---	--	--	--

		krahasuar me shënime: kontabël dhe pasqyrën e pozitës financiare, ishin nënvlerësuar në shumën 16,040€.					
3	Opinioni i Kundert	Ndërmarrjet Publike me rastin e bierjeve të mallrave dhe shërbimeve kanë për obligim të respektojnë procedurat sipas kërkesave të Ligjit të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës Nr.04/L-042. Trajtimi i jonë i bierjeve të realizuara ka nxjerrë këto përfundime: - Në katër raste janë realizuar bierje të pasurive përmes ankandit publik në vlerë totale 91,148€, duke mos realizuar procedurat adekuate sipas Ligjit për Prokurim Publik, e që rrjedhimisht nuk kanë as marrëveshje kontraktuale për pasuritë e blera: - Në tetë raste në shumën 42,644€, Kompania nuk kishte lidhur marrëdhënie kontraktuale për furnizim me mallra dhe shërbime, në të cilën do të specifikonte të gjitha të drejtat dhe detyrimet dhe çmimet e tyre. Përveç kësaj, nuk kishte	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që përmes akteve të brendshme të krijojë mekanizma të cilat do të siguronin se të gjitha bierjen e mallrave dhe shërbimeve të jenë në harmoni të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik në mënyrë që të arrihet transparenca dhe konkurrenca e nevojshme dhe të sigurohet shfrytëzimi efikas i fondeve publike.	Nuk do të behet bierje ne ankade, do te zhvillohen proceduart sipas ligjeve ne fuqi te Prokurimit Publik	Menaxhmenti	Janar /2020	

		dëshmi për pranimin e mallrave dhe shërbimeve.				
9	Opinioni i Kundert	<p>Sipas SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare në njësi ekonomike duhet të përgatisë pasqyrat financiare të saj, me përjashtim të informacionit mbi rrjedhën e parasë, mbi bazën e kontabilitetit rritës. Qëllimi i pasqyrës së rrjedhës së parasë, sipas SNK 7, është për të plotësuar nevojat e përdoruesve të informacionit kontabël në lidhje me rezultatin monetar, me fluksin e lëvizjes së mjeteve monetare gjatë një periudhe kontabël. Vlera e parasë dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës në Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë ishte mbivlerësuar për 205,110€, si rrjedhojë e mos evidentimit me kohë të daljes së parasë. Kompania të njëjtën vlerë e ka prezantuar si dalje të parave nga aktivitetet operative edhe pse e njëjta nuk i takonte vitit 2019. Përveç kësaj, tek seksioni i aktiviteteve operative, ish-in mbivlerësuar të hyrat nga</p>	<p>Boardi i Drejtorëve të sigurojë, se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuar tek rrjedha e parasë për të siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë.</p>	<p>Do të bëhet korigjimi sipas SNK, dhe korigjimet e nevojshme teknike, të Pasqyra Rrjedha e Paras sipas SNK7.</p>	<p>Kontabiliteti dhe Financat</p>	<p>Dhjtore 2020</p>



		<p>grantet për 1,067,831€ dhe shpenzimet e provizionit të llogarive të arkëtueshme në vlerë 323,175€. Po ashtu, ky seksion nuk përmban: shumën 195,057€ për të hyrat e shtyra dhe shumën 15,729€, e cila rrjedhë nga pasuritë tjera. Tërja, bazuar në çështjet e ngritura për zërat kontabël si, të arkëtueshmet, të pagueshmet dhe zhvlerësimi, zëra të aktiviteteve operative të rrjedhës së pasasë, vijmë në përfundim se rrjedha e pasasë nuk prezanton një informacion të saktë.</p>				
10	Opinoni i Kundert	<p>Sipas SNK 8 - Politikat Kontabël, Ndrvshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet, paragrafi 4.1. gabimet materiale ndonjëherë mbeten të pazbuluara deri në periudhat e më vonshme dhe këto gabime të periudhave paraardhëse, korrigjohen në informacionin krahasues të paraqitur në pasqyrat financiare për periudhat e më vonshme. Auditimi i pasqyrave financiare për</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë që të bëhen korrigjimet e gabimeve materiale të identifikuar të pasqyrave financiare të periudhave paraprake me një ri deklaram retrospektiv, si dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për</p>	<p>Do të behet korrigjimi sipas SNK, dhe korrigjimet e nevojshme teknike, të Pasqyra Rrjedha e Paras sipas SNK7.</p>	<p>Kontabiliteti dhe Financat</p>	

		<p>vitin 2018, kishte identifikuar një gabim material që ka të bëjë me mbivlerësimin e pasasë së gatshme në shumën 205,110€. Ky gabim material i periudhës paraprake, me rastin e hartimit të pasqyrave financiare për vitin 2019, nuk ishte korigjuar me një deklaram retrospektiv të shumës së pasasë së gatshme të vitit 2018, si informacion krahasues i pasqyrës së pozicionit financiar. Përveç kësaj, nuk ishte korigjuar shuma e pasasë së gatshme në fillim të periudhës edhe në Pasqyrën e Rrjedhës së Pasasë si dhe shuma e pasasë të gatshme në fillim të periudhës në Pasqyrën e Shënimeve Shpjeguese. Sipas konfirmimeve zyrtare është konsideruar mjaftueshëm prezantimi i gabimit si dalje e parave të vitit 2019 me qëllim të korigjimit.</p>	gabimet e periudhës së mëparshme.				
11	Opinoni i Kundert	<p>Sipas SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare, një pako e pasqyrave financiare, duhet të përmbajë edhe një pasqyrë të ndryshimeve në</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se është bërë një analizë e shkaqeve të cilat kanë</p>	<p>Do të behet korigjimi sipas SNK, dhe korigjimet</p>	<p>Kontabiliteti dhe Financat</p>		

		<p>ekuitet, e cila paraqet një përmbledhje të të gjitha ndryshimeve në ekuitet.</p> <p>ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE 7</p> <p>Çështjet e ngritura brenda këtij kapitulli, në lidhje me rezervën e rivlerësimit, të hkrat e shtyra, të hyrat nga grantet dhe shpenzimet e zhvlerësimit të cilat kanë ndikim në rezultatin financiar në pasqyrën e të ardhurave, kanë efekt gjithashtu edhe në pasqyrim të pasaktë të fitimit të periudhës të bartur në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet.</p>	<p>ndikuar në keqprezantimin e pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet dhe të ndërmerren veprime për t'i adresuar këto shkaqe në mënyrë sistematike për të siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të saj.</p>	<p>e nevojshme teknike.</p>			
12	Opinoni i Kundert	<p>Sipas SNK 2 – Paracitja e pasqyrave financiare, në element i pandarë i pasqyrave financiare janë shënime shpjeguese të tyre. Sipas përcaktimeve të bëra në këtë standard këto shënime të pasqyrave financiare duhet të paraqesin informacion në lidhje me bazat e përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare si edhe në lidhje</p>	<p>Borci i Drejtorëve të sigurojë, që shënime shpjeguese të përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave janë dhënë sipas</p>	<p>Do të korigjohen Pasqyra e Shpalosjeve dhe do të bëhet të gjitha shpjegimet e nevojshme, sipas SNK.</p>	<p>Kontabiliteti dhe Financat</p>	<p>Dhjetore 2020</p>	

	<p>me politikat kontabël të zgjedhura dhe të aplikuara për ngjarjet dhe veprimet më të rëndësishme; sqarojnë informacionin e kërkuar nga SNK; japin informacione shitesë i cili nuk është paraqitur në pasqyrat financiare por i cili është i nevojshëm për një paraqitje të drejtë të tyre. Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare mungonin informata të rëndësishme të cilat janë në kundërshtim me kriteret përkatëse të paraqitura në vijim: - Sipas SNK 18, shënimet shpjeguese duhet të paraqesin informacion lidhur me politikat specifike kontabël për bazën e matjes; për rritjet dhe uljet që rezultojnë nga rivlerësimet, humbjet nga zhvlerësimi të njohura në fitim ose humbje, datën e hyrjes në fuqi të rivlerësimit; nëse është përfshirë një vlerësues pavarur; tepricën e rivlerësimit, duke trëguar ndryshimin për periudhën dhe çdo kufizim në shpërndarjen e tepricës tek</p>	<p>kërkesave të standardeve të kontabilitetit.</p>				
--	--	--	--	--	--	--

	<p>aksion-mbajtësi, shumën e angazhimeve kontraktuale për blerjen e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), shtesat dhe të tjera.</p> <p>Shënimet shpjeguese nuk përmbajnë informacione, sipas kërkesave të SNK 16, edhe përkundër rivlerësimit të bërë të pasurive dhe ndryshimeve të mëdha të ndodhura për këtë zë kontabël. - Sipas SNK 2 -</p> <p>Stoqet, duhet të paraqesin informacion shpjegues, në lidhje me politikën kontabël për matjen e stoqeve, përfshirë formulën e kostos së përdorur. Shënimet shpjeguese nuk përmbajnë informacione, sipas kërkesave të SNK 2, lidhur me metodën e përdorur të njohjes së kostove të stoqeve. - Të paraqesin informacion shpjegues në lidhje me politikën e provizionimit të të ardhmësive. Shënimet shpjeguese nuk përmbajnë informacion të plotë, lidhur me politikën dhe provizionimin e llogarive të</p>					
--	---	--	--	--	--	--

	<p>arkëtueshme. - Të paraqesin informacion në lidhje me njohjen e të hyrave. ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE S Informacioni i dhënë në shënime: shpjeguese, në lidhje me të hyrat e realizuara, nuk korrespondon me të njëjtën shumë me të hyrat e prezantuara në pasqyrën e të ardhurave. Diferenca është për 11,823€. - Sipas SNK 20 - grantet qeveritare, duhet të paraqesin informacion shpjegues, për politikën kontabël të përdorura për grantet natyrën dhe madhësinë e granteve qeveritare të njohura në pasqyrat financiare dhe kushtet e paplotësuara të lidhura me ndihmën qeveritare. Shënime shpjeguese nuk përmbajnë asnjë informacion specifik, sipas kërkesës së SNK 20, në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për grantet e marra, edhe përkundër se të hyrat e shtyra nga grantet</p>					
--	--	--	--	--	--	--

	<p>shin në shumën 135,047€. - Sipas kërkesave të SNK 37 - pasuritë dhe detyrimet kontingjente (eventualitetet), duhet të paraqesin informacion shpjegues, përveç kur mundësia e një hyrje/daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më. Shënime: shpjeguese nuk përmbajnë informacion, për ngjarjet të cilat i plotësojnë kushtet për trajtimin e tyre si pasuri/ detyrime kontingjente. Ato ngjarje ekonomike kanë të bëjnë me 13 lëndë gjyqësore. - Përveç këtyre çështjeve të listuara më sipër, shënimet shpjeguese, nuk përmbajnë informata për zërin pasuritë tjera të hvrat e shtyra, provizionet afatshkurtra dhe për të ardhurat financiare.</p>					
13	<p>Në regjistrin e konsumatorëve të ndërmarrjes, ekzistojnë 1,734 konsumatorë, të cilët janë evidentuar me emërtimin "XX", e që janë kreditor ndaj ndërmarrjes në shumën prej 124.627€. Këto</p>	<p>2 Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që brenda një afati të përcaktuar kohor sa më të shkurtër, të shqyrtojë dhe të marrë masat e nevojshme</p>	<p>Do të bëhet identifikimi, i klienteve të cilat kanë të dhenat dhe adresat të sakt, pjesa</p>	<p>Kontabiliteti dhe Financat</p>	<p>Shtatore- Chjetor/2020</p>	

		<p>raste kanë ndodhur, kur klienti nuk është i pajmëruar ose nuk është gjendur në pronën e vet (ekonomi familjare) dhe për këtë arsye inkasatët i kanë evidentuar si "klienti XX".</p>	<p>përmirësuese, në mënyrë që të gjithë konsumatorët e evidentuar me emërtimin "XX" të regjistrohen në emër të shërbëtuesve të shërbimit. Për më tepër, të sigurohet që shuma kreditore e evidentuar përcaktohet për secilin prej tyre dhe se po merren masat e nevojshme për arkëtime.</p>	<p>tjetere sipas vendimit të bordit do të veprohet.</p>		
14		<p>Kompania në fund të vitit kishte bërë numërimin e stoqeve dhe kishte hartuar raportin për inventarizimin e stoqeve në bazë të cilit është bërë harmonizimi në libër kryesor. Mirëpo, testimet tona tregojnë çështjet në vijim: - Kompania pas raportit të komisionit të inventarizimit si dhe krahasimit me evidencat kontabël ka konstatuar mungesa të stoqeve në vlerë prej 25,723€ si dhe tepërca në vlerë prej 23,253€, por të njëjtat nuk janë trajtuar për</p>	<p>Bordi Drejtorëve të sigurojë, që pas procesit të inventarizimit të trajtoj shkaqet e diferencave të stoqeve. Po ashtu, të bëjë harmonizimin e gjendjes faktike me gjendjen në librat kontabël, duke identifikuar të gjitha mos harmonizimet për të prezantuar gjendjen e saktë të</p>	<p>Do të merren masat bashku me programerin dhe shefin e Depos, për identifikimin dhe regjistrimin e artikujve vetëm me një kod!</p>	<p>Shefi i Depos, Programeri, Në menaxhimin e ZKF.</p>	<p>Shtatore-Dhjetor 2020</p>



		<p>të identifikuar shkaku e ndodhjes. Për më tepër, vetëm diferenca në mas të tepricës negative dhe pozitive është trajtuar si numbje. - Në një rast harmonizimi i stoqeve në librat kontabël nuk përputhet me sasinë në raportin e komisionit të inventarizimit duke mbivlerësuar stoqet për 377€. - Në katër raste sasia e stoqeve në raportin e komisionit për inventarizim krahasuar me gjendjen faktike të tyre është mbivlerësuar për 7 389€ dhe në një rast është nënvlerësuar për 95€. në bazë të këtyre shifrave ishte bërë edhe regjistrimi në kontabilitet.</p>	<p>tyre në Pasqyrat financiare.</p>				
15		<p>Testimet tona tregojnë se, në dy raste ishin njohur parapagime në vlerë 7,365€, mirëpo bazuar në dëshmitë përkatëse vlera për këto parapagime ishte 200€. Kjo kishte ndodhur për shkak se, këto parapagime kishin të bëjnë me disa konteste gjyqësore me dy punëtorë për të cilët ishin marrë</p>	<p>Krvesuesi i Bordit të sigurojë, që në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare të prezantohen vetëm parapagimet që lëndin nga veprimet rregulluese për to, si dhe janë marrë masat e nevojshme</p>	<p>Do të vepronet sipas vendimeve të gjykatës!</p>	<p>Sherbimi Juridik</p>	<p>Dnjtore 2020</p>	

		vendimet gjyqësore në vitet paraprake, por të cilat nuk ishin harmonizuar me shënimet kontabël.	korrigjuese për të pasur një prezantim të drejtë të parapagimeve.				
16		Testet tona tregojnë se, tri asete të cilat ishin shitur gjatë vitit 2019, ende figurojnë në regjistrin e aseteve të Kompanisë. Vlera neto e tyre në datën e shitjes ishte zero, megjithatë, ato ishin rivlerësuar në vlerë totale 16,566€, duke mbivlerësuar vlerën e aseteve për këtë shumë. Bazuar në konfirmimet zyrtare, gabimisht nuk ishte bërë dalja e aseteve si dhe për arsye të njëjtë ishte bërë edhe rivlerësimi i tyre. Megjithatë, kjo çështje është rregulluar gjatë vitit 2020	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë marrë veprimet korrigjuese në lidhje me ndryshimet e nevojshme në regjistrin e pasurisë, sipas gjendjes faktike të tyre.	E rregulluar në 2020! Nuk ka pasur implikime financiare as në raporte!	Kontabiliteti dhe Financat	E kyer!	
17		Testet tona tregojnë se, 19 pasuri të cilat ishin në regjistrin e aseteve kishin vlerën neto në libra zero, mirëpo ato nuk ishin rivlerësuar fare. Sipas konfirmimeve zyrtare edhe pse këto asete figurojnë në regjistër, nuk janë rivlerësuar për shkak që i janë përcorur pjesët e tyre për asetet tjera. Megjithatë, kjo nuk na është	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, ri trajtimin e pasurive me vlerë zero në libra, në mënyrë që ato të mbahen sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.	Do të formohet një komisioni Profesional, i cili do të beje vlersimin e ketyre aseteve!	Sherbimi Operativë së Bashku me Kontabiliteti dhe Financat.	Tetora 2020	

		cëshmuar me ndonjë dëshmi përkatëse.					
18		Testet tona tregojnë se, me rastin e regjistrimit të zhvlerësimit të aseteve pas rivlerësimit, nuk kishte zvogëluar rezervën e rivlerësimit për pjesën shtesë të pasurive. Shuma që do të duhej t'i debitohet rezervës së rivlerësimit të emër të zhvlerësimit është 23,582€	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të merren veprime korigjuese që shpenzimet e zhvlerësimit të regjistrohen sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit, në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë gjendjen e saktë të tyre	Do të korigjohen sipas SNK8	Kontabiliteti dhe Financat	Chjetore 2020	
19		Detyrimet për TVSH ishin prezantuar në shumën 627€. Mirëpo, bazuar në analizat tona në "Deklaratat tatimore" si dhe nga "Gjendja e përgjithshme të deklarimeve e transaksioneve tjera të tatimpaguesit", rezultoi se Kompania nuk është kreditore ndaj Administratës Tatimore, por ka një tepëriçë debitore prej 5,882€.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë marrë veprimet korigjuese për deklarimin e TVSH-së së, në mënyrë që të dhënat kontabël dhe shumat e prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar, të jenë në harmoni me gjendjen e llogarive tatimore në Administratën Tatimore.	Do të bëhet Harmonizimi sipas Librave dhe korigjimin se bashku me zyrtartet e ATK-se	Kontabiliteti dhe Financat	Chjetore 2020	

20	<p>Testet tona tregojnë se në 32 raste, në shumën 12,186€, Kompania për shërbimet e saj të cilat i ofron për institucione publike i kishte faturuar duke u bazuar në m2 apo numër të nxënësve, e jo siç është e përcaktuar me rregullore në bazë të llojit dhe zbrazies së kontejnerëve. Ndërsa në 6 raste tjera, në shumën 35,647€, Kompania kishte lidhur kontrata me konsumatorët (institucione), mirëpo çmimi i kontraktuar nuk ishte në harmoni me rregulloren e Komunës së Prishtinës. Për më tepër, për 45 raste, Kompania nuk posedon dëshmitë (raporte operative) lidhur me ofrimin e shërbimeve dhe në gjë e tillë pamundëson nxjerrjen e efektit financiar të këtyre pa rregullsive.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që mos pajtueshmëritë ligjore të korrigojnë sa më shpejt që është e mundur, duke aplikuar tarifa shërbimi të caktuara nga komuna si organ kompetent, si dhe për çdo faturë të sigurohen dëshmitë lidhur me ofrimin e shërbimit.</p>	<p>Shefi i faturimit do të beje korigjimin dhe do të percjell te gjitha kontrata ne menyre qe faturimi te behet sipas kontrateve, po ashtu do te punehet ne perpunimin e rregullore per te hyra.</p>	<p>1. Shërbimi i Faturimit, Nene menaxhimin e ZKF-se. 2. Menaxhmenti i Kompanise.</p>	<p>Shtatore-Dhjetore 2020.</p>	
21	<p>Testet tona tregojnë se në dy raste Kompania kishte realizuar shërbime më shumë se vlera e faturuar duke nën faturuar Komunën në vlerë 2,722€, ndërsa në një rast kishte mbij faturuar në vlerë 7,015€. Bazuar në</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që brenda një afati sa më të shkurtër janë marrë masat e nevojshme përmirësuese për rastet kur faturimet</p>	<p>Shefi i faturimit do të beje korigjimin dhe do të percjell te gjitha kontrata ne</p>	<p>Shefi i Faturimit, Menaxheri i Kontrates, nene menaxhimin direkt te ZKF-se.</p>	<p>Shtatore-Dhjetore 2020.</p>	

		<p>konfirmimet zyrtare të menaxherit të Higjienës Publike të Kompanisë, nën faturimi ka ndodhur si pasojë e kryerjes së shërbimeve bazuar në kërkesat shtesë për shërbime nga Komuna e Prishtinës. Ndërsa mbi faturimi është si rrjedhojë e mungesës së evidentimit në ditaret e punës të ngarkesës së shpenzimeve të kriticës dhe rërës.</p>	<p>nuk janë në përputhje me shërbimet e ofruara dhe të siguroj që të bëhen harmonizimet në mes të ndërmarjes dhe Komunës së Prishtinës.</p>	<p>menyre qe faturimi te behet sipas kontrateve.</p>			
22		<p>Kompania, faturimin për shërbimet e ofruara në muajin korrik, nuk e kishte realizuar duke u bazuar në kushtet e kontratës adekuate, por në marrëveshjen paracrahe të shfuqizuar, e kjo ka rezultuar me nën faturim të të hvrave në shumën 7,519€. Ndërsa, për shërbimet e ofruara në muajin shtator, Kompania me rastin e faturimit nuk kishte dëshmi mbi përcaktimin e numrit të konsumatorëve. Një raport mbi përcaktimin numrit të konsumatorëve e kishte pranuar me datë 22.11.2019.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që brenda një afati sa më të shkurtër kohor, të bëjë harmonizimet në faturim dhe numër të konsumatorëve në mes të Kompanisë dhe Komunës së Graçanicës, dhe të bëhen korigjimet në shënimet kontabël. Po ashtu, të sigurojë që faturimi të bëhet vetëm atëherë kur numri i konsumatorëve është përcaktuar</p>	<p>Shefi i faturimit do te beje korigjimin dhe do te percjell te gjitha kontrata ne menyre qe faturimi te behet sipas kontrateve.</p>	<p>Shefi i Faturimit. Menaxheri i Kontrates, nene menaxhimin direkt te ZKF-se.</p>	<p>Shtaore-Dhjetore 2020</p>	

			nga projekt menaxheri i komunës në bashkëpunim me koordinatorin e Kompanisë.				
23		Kompania nuk kishte rregullore për menaxhimin e të hyrave e cila duhet të përshtatet me nevojat dhe kërkesat e saj duke u mbështet në standardet dhe rregullat në fuqi.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, hartimin e rregullores për të hyrat, e cila përmban procedura të qarta për menaxhimin e secilit lloj të të hyrave.	Do të punohet dhe do të prezantohe rregullorja për të Hyra.	Menaxhmenti së bashku me Bordin e Drejtorëve.	Shtatore-Dhjetore 2020.	
24		Bazuar në konfirmimet zyrtare të pranura nga Kompania, gjenerimin (shtypjen) e faturave e kishte bërë KRM Pastrimi. Mirëpo, ky shërbim ishte i përcaktuar me kontratë që të realizohej nga Komuna e jo nga Kompania, dhe si i tillë nuk ishte pasuar me ndonjë aneks kontratë. Përveç kësaj, numri i konsumatorëve të faturuar ishte më i lartë nga ajo që ishte përcaktuar në kontratë. Kështu, përgjatë tremujorëve (tutje TM), për TM1 ishin faturuar 64,350 konsumator, për TM2 67,835	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, një analizë të saktë të kostos së shërbimit, numrin e konsumatorëve të shërbyer si dhe të rishqyrtoj edhe njëherë kushtet e kontratës me Komunën e Prishtinës të cilat duhet të reflektohen në ndonjë aneks kontratë.	Do të zhvillohen negociata me Komunen e Prishtines për rritjen e numrit të klienteve për faturim, dhe do të kërkohej nje aneks per pagesen per shërbimet	Bordi së bashku me Menaxhmentin.	Shtatore-Dhjetore 2020.	

		konsumatorë, për TM2 69,575 konsumatorë ndërsa gjatë TM4 69,540 konsumatorë. Ndërsa në anën tjetër, Kompania kishte faturuar Komunën bazuar në numrin e konsumatorëve të përcaktuar në kontratë 54,000 përkatësisht 56,000		e kryere per shpërndarj en dhe shtypjen e faturave.			
25		Bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike nr.03/L- 037, neni 20.4, Komisioni i Auditimit do të përgatisë dhe do të zbuloj në mënyrë publike një deklaratë për politikën e kompensimit për drejtorët dhe zyrtarët e NP- së. Gjithashtu, sipas statutit të Kompanisë, neni 9, ndërmarrja duhet të nxjerrë rregullore të cilat përmbajnë dispozitat për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë.	Bordi i Drejtorëve përmes Komisionit të Auditimit të përgatis dhe të bëjë publike një rregullore/politikë për kompensimin e drejtorëve dhe zyrtarëve, në përputhje me strukturën organizative.	Kompensim i do të behët sipas ligjit për kompensim in e antareve të bordit me miratimin e Aksionerëve.	Aksionerët së bashku me Bordin dhe Menaxherin e Kompanisë.	2020	
26		Kompania dhe Komuna e Graçanicës kishin lidhur një Marrëveshje mirëkuptimi me qëllim të mirëmbajtjes së pastërtisë dhe higjienës publike. Sipas kësaj Marrëveshje, Komuna nëpërmjet Kompanisë do të angazhojë punonjës të nevojshëm për kryerjen e	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që përmes rregulloreve të brendshme të përcaktojë kontrolle të brendshme, të cilat do të parandalonin pagesat e pagave	Do të behet harmonizimi sipas kontratave të cilat janë në fuqi.	Menaxhmenti i Kompanisë.	Shtatore /2020	

		<p>shërbimeve, kundrejt një pagese mujore duke përfshirë në këtë shumë tatimet dhe kontributet (ndalesat) ligjore ndaj Kompanisë. Bazuar në këtë, Kompania kishte lidhur kontrata me 49 punonjës deri në muajin maj. Mirëpo, kishte vazhduar angazhimin e këtyre punonjësve eche për muajin qershor dhe ka paguar pagat e tyre edhe pse kontratat e tyre kishin skaduar. Sipas zyrtarëve të Kompanisë, arsyeja e mos mbulimit me kontrata të punës për punonjësit e angazhuar në muajin qershor, ishte se Kompania ka qenë në proces të ndryshimit dhe harmonizimit të marrëveshjes me Komunën e cila ka marrë kohë</p>	të punëtorëve pa kontratë pune.				
27		<p>Në planin e biznesit për vitin 2019, Kompania kishte planifikuar që numri maksimal i aprovuar i punëtorëve në fund të vitit të jetë 600 të punësuar dhe 3,343.618€ shpenzime për paga dhe mëditje. Mirëpo, gjatë vitit 2019 Kompania</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që përmes akteve të brendshme të Kompanisë të krijoj mekanizma adekuat të cilët do të pamundësojnë punësimin e</p>	<p>Do të veprohet sipas Planit të Biznesit i cili është i miratuar nga Boardi i Drejtorëve.</p>	<p>Menaxhmenti i Kompanisë</p>	<p>Shtatore 2020</p>	



		<p>kishte punësuar 107 punonjës të rregullt dhe 133 punëtorë për punë dhe detyra specifike. Në fund të vitit, numri i të punësuarve ishte 579 punonjës të rregullt dhe 55 punonjës për punë dhe detyra specifike. Rritja e numrit të të punësuarve mbi nivelin e aprovuar në planin e biznesit ka rezultuar në tejkalim të shpenzimeve të pagave për 553,039€ mbi shumën e planifikuar, prej të cilave 284,525€ ishin shpenzuar për punonjës për punë dhe detyra specifike.</p>	<p>punëtorëve mbi numrin e planifikuar nga organet kompetente si dhe monitorimin e vazhdueshëm të shpenzimeve të pagave në raport me planifikimet. Në rastet kur shfaqet nevoja për staf shtesë, kjo të mbështetet me rishikim të planit të biznesit me kohë.</p>				
28		<p>Kompania, në vitin 2018, kishte lidhur një memorandum të mirëkuptimit me MPMS3 për punësimin e përkohshëm të 25 punëtorëve4, me qëllim të përmirësimit të mirëmbajtjes së ambientit në tërë territorin e Komunës së Prishtinës për periudhën maj 2018 deri prill 2019. Mirëpo, pas përfundimit të këtij memorandumit, Kompania kishte formuar një komision për të vlerësuar performancën e treguar nga</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që përmes kontrolleve të brendshme të parapara në aktet e ndërmarrjes të parandalojë punësimin e punonjësve pa zhvilluar proces konkurrues sipas legjislacionit në fuqi.</p>	<p>Do të veprohet sipas ligjeve në fuqi për të punuarit, duke respektuar dhe jave mundësuar që të gjithë të jenë të barabartë, dhe sipas kualifikimeve të bëhet</p>	<p>Sherbimi Juridik</p>	<p>Dhjetore 2020</p>	<p>Jemi referuar në bazë të nenit 3.8 të marrveshjes Nr.Prot -2777 të dt.29.10.2018, si dhe Procesverbalit për rekrutim nga MPMS</p>

		këta punëtorë gjatë kësaj periudhe. Mbi konstatimin e performancës së mirë nga komisioni, ndërmarrja kishte punësuar gjashtë nga 25 punonjësit e lartpërmendur pa shpallur konkurs publik dhe pa zhvillim të procedurave të hapura të cilat sigurojnë transparencë dhe konkurrencë të lirë për punë.		edhe perzgjedhja e punotreve me te mire.			
29		Trajtimi i jonë për procedurat e rekrutimit tregon se për rekrutimin e pesë të punësuarve përmes kryerjes së tri procedurave të rekrutimit, Kompania nuk kishte respektuar afatin për formimin e komisionit të përzgjedhjes duke formuar komisionin deri me 16 ditë vonesë.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që përmes akteve të brendshme të parandalojë mos respektimin e afateve kohore gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit për punësimin e punonjësve	Do të respektohen të gjitha afata të parapar sipas ligjeve në fuqi.	Sherbimi Juridik	E kryer ne dhjatore 2019	
30		Testet tona tregojnë se, në pesë procesa të rekrutimit nuk ishin anuluar konkurset për tu përsëritur edhe pse nuk kishte së paku tre kandidatë të cilët kanë plotësuar kushtet e konkursit.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që në rastin e punësimeve të kryhen procedurat e rekrutimit vetëm kur së paku tre nga kandidatet i plotësojnë kushtet e konkursit, në të	Do të respektohen të gjitha afata të parapar sipas ligjeve në fuqi.	Sherbimi Juridik	Gushte 2020.	

			kundërtën konkursi të përsëritet.				
31		Në tri procese të rekrutimit për pranimin e pesë punonjësve, komisionet për zhvillimin e proceseve të rekrutimit nuk kanë përpiluar një procesverbal për të listuar kandidatët të cilët kanë konkurruar dhe për të njëjtit nuk është dëshmuar nëse kanë plotësuar kriteret e konkursit. Përveç kësaj, pas përfundimit të proceseve të testimit me shkrim dhe me gojë nuk kanë hartuar një procesverbal me pjesëmarrësit sipas renditjes së pikëve të fituara, për të dëshmuar kandidatin më të suksesshëm.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që komisionet e themeluara për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, kryejnë detyrën e caktuar në përputhje me kërkesat ligjore, duke eliminuar kështu mundësinë e manipulimit të rezultateve të kandidatëve.	Do të respektohen të gjitha afata të parapar sipas ligjeve në fuqi.	Sherbimi Juridik	Gushte 2020.	
32		Testimet tona tregojnë se, në një rast e punësuar pas përfundimit të kontratës për punë dhe detyra specifike në muajin qershor 2019, është paguar edhe gjatë muajit korrik përderisa për këtë muaj nuk ka dëshmi të vijueshmërisë në punë si dhe kontratë pune. Po të njëjtin muaj edhe një punëtorë tjetër, i cili kishte	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që përmes akteve të brendshëm të krijojë kontrole adekuate, të cilat do të parandalonin dhe eliminonin rastet e pagesës së punëtorëve pa kontrata dhe pa dëshmi të	Jane mare te gjitha masat per personat pergjegjesis te cilet nuk i kan listuar vijushmerine e puntoreve!	Menaxheri i Kontrollas Intenren!	Janar 2020	

		marrëdhënie pune të idhur me ndërmarrjen është paguar pa dëshmi të vijueshmërisë në punë.	vijueshmërisë në punë. Ndërsa në rastet, kur ndodhin gabime eventuale, të bëhen ndalesa në pagat gjatë muajve në vijim.				
33		Kompania, gjatë vitit 2019, kishte angazhuar 133 punonjës për punë dhe detyra specifike, mirëpo këta punonjës mbulonin pozitat e rregullta të punës dhe për të njëjtit nuk kishte zhvilluar procedura të rekrutimit. Për më tepër, 50 prej tyre shpesh angazhuar gjatë tërë vitit.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që me rastin e themelimit të marrëdhënieve të punës të zhvilloj procese të rekrutimit në mënyrë të rregullt dhe transparente dhe se pozitat e rregullta mbulohej me kontrata të rregullta të punës	Do të veprohet sipas ligjeve në fuqi për të punuarit, duke respektuar dhe jave mundësuar që të gjithë të jeni të barabartë, dhe sipas kualifikimeve të bëhet edhe përzgjedhja e punotreve me të mire.	Sherbimi Juridik	Gushte 2020	
34		Në përputhje me kërkesat e ligjit për NP-të, Komisioni Komunal i Aksionarit, me datë 22.08.2016 kishte marrë vendim, që anëtarët e Bordit të Drejtorëve të	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që çërmes akteve të brendshme të krijojë kontrolle adekuate të cilat	Do të veprohet sipas ligjeve në fuqi për komepnzim	Bordi dhe Menaxhmenti	Shtatore 2020	

		<p>Kompanise, do të kompensohen vetëm me pagë mujore. Mirëpo pavarësisht kësaj gjatë muajit qershor, me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv, Bordi i Drejtorëve ishte kompensuar me pagë shtesë, në emër të mbajtjes së mbledhjes së jashtëzakonshme në shumë totale prej 2,370€.</p>	<p>do të parandalonin kompensimet e anëtarëve të Bordit mbi vendimet e marra nga organet kompetente të autorizuara nga ligjet në fuqi.</p>	<p>in e antareve te Bordit.</p>			
35		<p>Me vendim të Komisionit Komunal të Aksionarit (KKA), të datës 28.03.2019, në muajin maj 2019 Bordi Drejtues dhe Zyrtarët e Lartë kishin pranuar pagë shtesë (100% të honorarit tmemelor) në emër të performancës pozitive pas auditimit të pasqyrave financiare vjetore në shumë 4,417€, duke tejkaluar kështu edhe limitin e përcaktuar prej 50%. Mirëpo, Kompania deri në qershor 2019 nuk kishte pranuar raportin e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2018, raport i cili ka rezultuar me opinion të kundërt.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të gjitha kompensimet e Drejtorëve dhe Zyrtarëve të lartë, të bëhen sipas politikës së kompensimit si dhe vendimeve të aksionarëve.</p>	<p>Do te respektohen ligjet ne fuqi per kompenzim in e antareve te Bordit</p>	<p>Aksioneret dhe Bordi</p>	<p>Shtatore 2020</p>	

36		<p>Me planin vjetor të prokurimit, ishte planifikuar të kryhen 41 procedura të prokurimit, me vlerë totale të parashikuar 2,535,432€.</p> <p>Analiza jonë e këtij plani tregon që, ishin realizuar 77 procedura të prokurimit në vlerë 984,299€, prej të cilave, 46 nuk kanë qenë të përfshira në planin e prokurimit, në mesin e tyre një kontratë me vlerë të madhe (136,240€), pesë kontrata me vlerë të mesme (në total 259,027€), shtatë kontrata me vlerë të vogla (46,614€) dhe 33 kontrata me vlerë minimale 27,253€.</p> <p>Përveç kësaj, 28 aktivitete të parapara në planin e prokurimit në vlerë 1,595,747€ nuk ishin zhvilluar. Si rezultat i kësaj, realizimi i aktiviteteve të prokurimit krahasuar me aktivitetet e planifikuara ishte vetëm 37%.</p>	<p>Bordi i Drejtoreve të sigurojë planifikim të detajuar të aktiviteteve të prokurimit i cili do të shmangë në të ardhmen nevojat për ndarjen e kërkesave, si dhe do të sigurojë aplikimin e procedurave të duhura, siç janë kontratat publike kornizë. Përveç kësaj, të sigurojë që njësitë kërkuese, të parashtrojnë kërkesat me kohë për t'i lejuar zyrës së prokurimit planifikimin dhe iniciimin me kohë të aktiviteteve dhe procedurave të prokurimit.</p>	<p>Do të bëhet rishikimi i Planifikimit të prokurimit dhe se bashku me shefat e Departamenteve do të rishikohen kërkesat sipas nevojës për zhvillimin e punëve në mënyrë sa më të mirë.</p>	Zyra e Prokurimit dhe Menaxhmenti	Shtatore 2020	
37		<p>Testet tona tregojnë se, në pesë raste në shumën 126,281€, specifikimet teknike ishin hartuar në mënyrë diskriminuese, të pa krahasueshme dhe pa</p>	<p>Bordi i Drejtoreve të sigurojë, kontrole adekuate në mënyrë që specifikimet teknike në dosjen e</p>	<p>Do të zbatohen të gjitha procedurat e prokurimit</p>	Zyra e Prokurimit, Menaxheret e Kontratave dhe Menaxhmenti.	Shtatore 2020	

	<p>përshkrime specifike e jo sipas kërkesave të LPP. Nga trajtimi i tyre janë nxjerrë këto përfundime: - Për projektin "Shërbimet për shfrytëzimin e pajisjeve për printim, kopjim, skenim", në vlerë 28,801€, ishin hartuar specifikimet teknike duke specifikuar markën e produktit. Ndërsa te projekti "Furnizim me karrige", në shumë 760€, specifikimet teknike ishin hartuar në mënyrë jo të detajuara, pa përshkrime të specifikuara. - Për projektat "Furnizim me dy Kamionë-Abrolia (të përdorur)", "Furnizim me kamion kompaktor për Kontejner" dhe "Furnizim me kamion me 7m<sup>3</sup>", specifikimet teknike ishin hartuar, duke bërë kërkesë që viti i prodhimit të kamionëve të jetë më i ri se viti 1999, 1990 dhe 1993 përkatësisht, dukeënë hapësirë që ofertat të mos jenë të krahasueshme për nga viti i prodhimit. Vlera totale për këto tri procedurat ishte 96.720€. Sipas zyrtares së prokurimit,</p>	<p>tenderit të përcaktohen duke u bazuar plotësisht në dispozitat ligjore të ligjit të prokurimit, duke ofruar qasje të barabartë të gjithë operatorëve ekonomik.</p>	<p>sipas ligjeve ne fuqi, dhe nga menaxhere t e kontrateve do te kerkoet perkushtim me i madhe ne per bushjen e detyrave.</p>			
--	--	---	---	--	--	--

		<p>kjo ka ndodhur për shkak se, specifikacionet teknike ishin hartuar në këtë mënyrë nga njësisia e kërkesës si dhe në një rast tjetër për shkak mungesës së kontrollit nga ana e saj.</p>					
38		<p>Kompania ishte furnizuar me kamionë të përdorur përmes tri procedurave të prokurimit në vlerë totale 96,720€. Në këto procedura të prokurimit, ishin hartuar specifikimet teknike, duke bërë kërkesë që viti i prodhimit të kamionëve të jetë më i ri se viti 1999, 1990 dhe 1993. Marrë parasysh se në këto procedura kanë ofertuar më shumë se një operator ekonomik, krahasueshmëria është vështirë e realizueshme. Sipas arsyetimeve të dhëna nga zyrtarët e prokurimit, këto procedura të blerjeve të kamionëve të përdorur, ishin realizuar në mungesë të mjeteve financiare.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që para inicimit të procedurave të prokurimit, të mos ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik. Kriteret teknike duhet të sigurojnë që procesi i vlerësimit të ofertave të jetë i barabartë dhe jo-diskriminues. Përveç kësaj, duhet të siguroj që fondet</p>	<p>Do të veprohet sipas ligjeve të prokurimit dhe sipas mundësive Buxhetore per blerje.</p>	<p>Menaxhmenti dhe Zyra e Prokurimit.</p>	<p>Shtatore 2020</p>	



			publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike duke mundësuar që të merret vlera për paranë e dhënë.			
39		<p>Për shërbimet e shërvetëzimit të pajisjeve për printim, kopjim dhe skenim Kompania kishte bërë tejkalinin e furnizimeve në raport me kontratën në shumë prej 2,863 (përfshirë TVSn). Ndërsa, lidhur me furnizimet me naftë dhe shërbimet për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave sintazore në katër raste Kompania ishte mb. faturuar për 2,845€, kurse në një rast ishte nën faturuar në vlerë 532€. Tutje, me qëllim të ofrimit të shërbimeve për bartjen dhe transportin e mbeturinave inerte dhe të vëllimshme për Komurën e Prishtinës, Kompania kishte kontraktuar edhe një operator për të realizuar këto shërbime në mënyrë të përbashkët. Bazuar në dritarët e punës dhe faturat,</p>	<p>Bordi i drejtorëve të sigurojë, që brenda një afati sa më të shkurtër janë marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e furnizimeve kur sasia e kontraktuar është tejkaluar. Po ashtu, të merren veprime përmirësuese që mjetet në vlerë 24,935€ të kthehen në buxhetin e Kompanisë dhe të sigurojë që të bëhen harmonizimet në mes të furnitorëve dhe Kompanisë.</p>	<p>Do të zbatohen të gjitha procedurat e prokurimit sipas ligjeve në fuqi, dhe nga menaxheret e kontrateve do të kërkohet perkushtim me i madhe në perbushjen e detyrave.</p>	<p>Zyra e Prokurimi dhe Menaxheret e Kontratave.</p>	<p>Shtatore 2020.</p>

		<p>analizat tona tregojnë se, Kompania kishte faturuar Komunen e Prishtinës për mbeturinat inerte dhe të vëllimshme, në sasinë prej 59,998.38m<sup>3</sup>. Prej tyre 15,413.73m<sup>3</sup> ishin realizuar nga Kompania, ndërsa 44,584.65m<sup>3</sup> ishin realizuar nga kontraktori. Megjithatë, operatori kishte faturuar Kompaninë për 53,182.99m<sup>3</sup> që rezultoi me një mbi faturim në sasi në krahasim me punët e realizuara për 8,598.34 m<sup>3</sup>, shprehur në shumë monetare një mbi faturim për 24,935€. Për më tepër, ishte bërë tejkalimi i kontratës në shumë për 3 340€, mbi devijimin -30% të kontratës totale.</p>					
40		<p>Në kuadër të shpenzimeve për periudhën raportuese të vitit 2019, Kompania kishte njonur shpenzimet për shërbime të sistemit informativ në vlerë 30,000€ të cilat i takojnë vitit 2018. Sipas konfirmimeve zyrtare, arsyetja e mos regjistrimit të shpenzimit të ndodhur në periudhën përkatëse ishte pranimiti i faturës me vonesë.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të merren veprime korrigjuese në mënyrë që vlera e shpenzimeve të prezantojnë gjendjen e saktë të tyre, ashtu që ngjarjet ekonomike të ndodhura të rrihen në</p>	<p>Te gjitha shpenzimet do të regjistrohet me datën e leshurjes së fatures dhe pranimitit të shërbimit ose mallit, sipas SNK dhe</p>	<p>Kontabiliteti dhe Financat</p>	<p>Gusht /2020</p>	

			ber vohën e noodhjes.	politikave fiskale.			
41		Bordi i Drejtorëve kishte marrë vendim për ndarje të mjeteve monetara në vlerë prej 18,720€ për të punësuarit me rastin e Festës së Pavarësisë. Këto pagesa nuk ishin përfshirë në pagat bruto të punonjësve, por ishin ishte realizuar me para në dorë nga Arka Qendrore e Kompanisë dhe regjistrimet në kontabilitet ishin bërë në kuadër të shpenzimeve operative në llogarinë "Shpenzimet e shtesave për Punëtorë". Arsveja e pagesave të tilla sipas konfirmimeve zyrtare, ishte bërë pasi që nuk kishin qasje në sistem që të hapnin konto të re në kuadër të pagave dhe mëditjeve.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që pagesat shtesë për të punësuarit, sipas vendimeve të menaxhmentit, të realizohen nëpërmjet sistemit të pagave dhe se janë zbatuar obligimet tatimore për to.	Do të respektohen ligji për tatimi i te ardhurave personale, dhe do të veprohet sipas ketti ligji.	Kontabiliteti dhe Financat	Janar 2020	
42		Menaxhmenti i Kompanisë nuk ka dëshmuar se në mënyrë sistematike përcjellë progresin e përmbushjes së rekomandimeve të dhëna nga NJAB. Mos përcjellja sistematike e progresit të përmbushjes së rekomandimeve të NJAB-së, nga ana e Menaxhmentit të	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që përmes akteve të brendshme të krijoj mekanizma të cilët do të siguronin që menaxhmenti i ndërmarrjes, në mënyrë të vazhdueshme bënë	Zyratër dhe Shefat e Departam enteve do të raportojne per permbushjen e rekomandi	ZKF, Sekretari i Kompanis.	Gusht 2020	

		Kompanisë, ka ndodhur për faktin se është konsideruar e mjaftueshme përcjellja e tyre vetëm nga ana e NJAB-së.	përcjelljen e përmbyshjes së rekomandimeve të dhëna nga NJAB sipas zotimeve në rekomandimet finale.	meve nga NJAB.			
43		Auditimi i Brendshëm gjatë vitit 2019, nuk ka zhvilluar asnjë trajnim të paraparë dhe aprovuar në planin vjetor të auditimit për po këtë vit. Sipas NJAB-së një gjë e tillë nuk është vlerësuar si e nevojshme nga menaxhmenti i institucionit.	Bordi i Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të auditimit të sigurojë, që Njësia e Auditimit të Brendshëm bazuar në standardet në fuqi, të zgjerojë njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tjera të auditorëve të brendshëm, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional.	Do të përcjellen të gjithat EVP sipas Standarteve të Auditimit të Brendshëm.	Zyrtari Kryesorë i Auditimit të Brendshëm.	Korrik/2020	
44		Funksioni i Auditimit të Brendshëm në Kompani, përbëhet vetëm nga një zyrtar i cili kryen auditimet dhe bënë rishikimin e tyre, që pamundëson sigurimin e një programi efikas të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së aktiviteteve	Bordi i Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të Auditimit të sigurojë, që Njësia e Auditimit të Brendshëm, të krijojë një program efikas të siguri	Do të hapet Konkurse për rekrutimin e Auditorëve të Çertiifikuar	Komisioni i Auditimit, Bordi i Drejtorëve.	Dhjetore 2020	

		<p>audituese. Sipas Zvartarit Kryesor të NJAB-së, edhe përkundër planifikimit për punëtor shtesë në Planin Strategjik të AB-së, si dhe kërkesë së vazhdueshme në Komitetin e Auditimit dhe Bordin Drejtues, nuk ka hasur në mirëkuptim për shtimin e punëtorëve.</p>	<p>chënies dhe përmirësimit të cilësisë së aktiviteteve të brendshme, përmes shtimit të burimeve njerëzore me njohuri të mjaftueshme në praktikën e auditimit të brendshëm.</p>				
--	--	--	---	--	--	--	--